



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:232313

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05566636

AC-I-23-0277

Në ankesën e

Paditësi

Z K, nga fshati Sh, Komuna Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati, **H G**, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, K.B "Bujqësia", Prishtinë (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Diellza Hoxha gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1738 të datës 12 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-13-1738 i datës 12 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 17 shtator 2013, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN009-0076 të datës 23 gusht 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 deri 31.01.2008, në shumën prej 1,837.00 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi në ankesë këtë vendim e konsideron si të kundërligjshëm, pasi që ai pohon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Tutje në ankesë ai pohon se kishte pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, nga ana e AKM-së, andaj duke u bazuar në këtë njoftim ai është paraqitë në procedurë të likuidimit me datë 15.10.2010, do të thotë në afatin ligjor, dhe nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0076 të datës 23 gusht 2013, njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, autorizimin e avokatit, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007.

Me datë 28 prill 2014, AKP-ja e dorëzon mbrojtjen në ankesë. AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja po ashtu pohon se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për periudhën 01.03.2007 deri më 31.01.2008 është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë në ankesën e tij se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 06 qershor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi e kundërshton qëndrimin e AKP-së se kërkesa për paga është parashkruar. Tutje paditësi pohon se ai e kishte pranuar njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, dhe sipas këtij njoftimi unë e kam paraqitur kërkesën tek Autoriteti

i Likuidimit kur ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Me datë 15 gusht 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë dhe kërkon nga gjykata që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 12 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1738, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe e detyron të paditurën ti paguaj paditësit pagat e pa paguara për periudhën 01.03.2007 e deri 31.08.2008, në shumë prej 1,837.00 euro, interesin ligjor prej 10% të shumës themelore ose në shumën prej 183.70 euro si dhe të paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të Njoftimit të lëshuar nga AKM-ja me datë 31 janar 2008, konstatohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura NSH "K.B Bujqësia" me të cilën është njoftuar paditësi se punësimi juaj ka përfunduar menjëherë, ndërsa pretendimet e tjera të paditurës se kërkesa është parashkruar nuk janë bindëse për Gjykatën. Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë afatin e parashkrimit të kërkesës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH-në, ndërsa NSH-ja i ka mbetur borxh paditësit në shumën e aprovuar prej 1,837.00 euro, e cila shumë nuk është kontestuar as nga AKP-ja me mbrojtje në ankesë. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësit i është njohur edhe interesi ligjor prej 10% në borxhin kryesor, në shumë prej 183.70 euro, që së bashku me borxhin kryesor do të paguhet në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Me datë 11 maj 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-1738, të datës 12 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy

çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet ti përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa. AKP-ja pohon se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës të cilit i referohet paditësi e informon atë se ai ka të drejtën të parashtroi kërkesën në AKP dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. Ky njoftim nuk mbron të drejtat e tij me mjetet e tjera ligjore që janë në dispozicion. AKP-ja ende e mbanë qëndrim se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 19 qershor 2023, paditësi e ka pranuar ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 15 tetor 2010, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, për kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH "KB Bujqësia" (në likuidim), për periudhën nga data 01.03.2007 e deri 31.01.2008, në shumë prej 1,837.00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit nuk i pranon si të sakta konstatimin e Autoritetit të Likuidimit, se kërkesa është parashkruar. Kjo për faktin se kërkesa për paga është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 15 tetor 2010, dhe ajo kërkesë i përket periudhës nga data 01.03.2007 e deri në 31.01.2008, që do të thotë nuk ka kaluar afati ligjor prej 3 viteve, për të ardhur në konstatimin se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi bashkë me ankesën në Shkallën e I-rë, ai ka dorëzuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN009-0076 të datës 23 gusht 2013, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, një kopje të bilancit të suksesit për ndërmarrjen, dhe një listë të pagave të punëtorëve të muajit shkurt 2007, në të cilën listë është edhe paditësi, dhe autorizimin e avokatit. Këto prova të ofruara nga paditësi, janë administruar nga ana e Gjykatës së Shkallës së I-rë.

Paditësi e kishte pranuar Njoftimin nga AKM-ja për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 31 janar 2008, në kohën kur ende nuk kishte ndodhë parashkrimi, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pas fillimit të procedurës së likuidimit, ai me datë 15 tetor 2010 e paraqet kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, në afat ligjor.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me listën e pagave të punëtorëve për muajin shkurt të vitit 2007, ai ka vërtetuar edhe lartësinë e tij të pagës mujore. Por duke marrë për bazë këtë provë, si dhe faktin se AKP-ja shprehimisht në mbrojtjen në ankesë, nuk e ka kontestuar lartësinë e kompensimit të kërkuar në emër të pagave, por AKP-ja e konteston vetëm çështjen e parashkrimit, Kolegji i Apelit, bazuar në këto prova që i ka sjellë paditësi në gjykatë, e ka aprovuar padinë e paditësit si të bazuar, dhe e ka detyruar të paditurën që ti paguaj paditësit shumën prej 1,837.00 euro, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.03.2007 e deri me 31.01.2008.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë, përveç borxhit kryesor, ai ka kërkuar edhe kamatën ligjore, andaj pasi që paditësi është i suksesshëm në padinë e tij, në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit po ashtu i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 183.70 euro, si dhe drejta në kompensimin e shpenzimeve në emër të pagesës së

taksës gjyqësore prej 20.00 euro, duke u bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, të cilat do të paguhen nga e paditura, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzoi ankesën e AKP-së si të pa bazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 14 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
